



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E KONCEPTIMIT DHE FIZIBILITETIT TE PROJEKTEVE TË  
INDUSTRIË DHE ENERGJISË

**Ftesë për Shërbim Konsulence, për paketën WP3 të Projektit G.A.T.E (Greece  
Albania Trans-Sectorial Energy)**

Në kuadër të programit IPA- CBC për vendet kufitare, Greqia në bashkëpunim me Shqipërinë do të zhvillojnë projektin: GATE “**Greece Albania Trans-Sectorial Energy**”, i cili do të kryhet në kuadër të programit “INTEREG-IPA II CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAME GREECE-ALBANIA”.

Qëllimi i këtij projekti është implementimi i teknologjive mjedisore për shfrytëzimin dhe ruatjen e energjisë në banesat publike që përcjellin impact social. Për këtë qëllim në përputhje me zonën ku zhvillohet programi është përzgjedhur Shkolla publike “Sëbashku” në Bashkinë e Gjirokastrës. Puna që do të kryhet në këtë banesë është ndërhyrja me masa për përdorimin eficient të enrgjisë si dhe shfrytezimin e burimeve të rinovueshme.

Puna e ekspertit/kompanisë do të zhvillohet në kryerjen e raporteve si:

- a) Përgatitja e Raportimeve të Projektit (del 1.3.3);*
- b) Raporti i komunikimit dhe informimit (del 2.3.2);*
- c) Studimi i plotë i fizibilitetit në godinën e shkollës “Sëbashku” në Bashkinë e Gjirokastrës (del 3.3.1) (Studimi i fizibilitetit do të përfshij, auditimin energjistik, bashkë me vizatimet përkatëse, si dhe një raport monitorimi);*
- d) Raporti i Monitorimit dhe Operimit të Godinës së Shkollës (Del 3.3.4).*

Objekti i kësaj pune synon një vlerësim të detajuar në përmirësimin e efijences së energjisë në objekt, për termoizolimimin e saj, zëvendësimin e dyerve dhe dritareve me dopjo xham, rritjen e efijencës së ndriçimit si dhe instalimin e një sistemi të ngrohjes dhe ujit të ngrohtë duke marrë në konsideratë dhe përdorimin e energjive të rinovueshme.

Në mbështetje të realizimit të paketave WP1, WP2 dhe WP3 kërkojmë nga ekspertet/kompanitë e interesuar që të paraqesin:

- i) Kërkesë për shprehje interesi;*
- ii) CV-në e Ekspertit/Kompanisë;*
- iii) Eksperienca në pune për projekte të ngjashme.*

Dokumenti i sipërcituar duhet të paraqitet pranë Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në fushën e Industrisë dhe Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, brenda datës 25 Nentor 2019 në adresën e mëposhtme.

**Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Industrisë dhe Energjisë**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë  
Rr. “Abdi Toptani”, Nr.1, 1001, Tiranë, Shqipëri  
E-mail: Erlin.Uznova@infrastruktura.gov.al

Duke Ju Falënderuar për mirëkuptimin!

**DREJTOR I PERGJITHSHËM**

**Gjergji Simaku**

